



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

---

Numri i lëndës: 2023:282720

Datë: 24.12.2024

Numri i dokumentit: 06650241

K.DH.SH.II.nr.476/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Dren Rogova, ne çështjen juridike përmbartimore të kreditorit KOSTT- Operator, Sistemi, Transmisioni dhe Tregu sh.a, me numër unik identifikues 811284512, me seli ne rr.”Isa Boletini” nr.39 ne Prishtinë, ndaj debitorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO) sha, me NUI811288887, me seli ne Bulevardin “Bill Klinton” pn ne Prishtinë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.2154/22 dt.30.11.2023, me datën 24.12.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e debitorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO) sha, me seli ne Bulevardin “Bill Klinton” ne Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.2154/22 dt.30.11.2023, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës– Dhomat e Shkallës se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2154/22 dt.30.11.2023, ne pjesën e I te dispozitivit te aktvendimit ka përfunduar procedurën përmbartimore sipas urdhrin P.nr.384/2022 dt.18.08.2022 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj, me seli ne Prishtinë, lidhur me kërkesën e kryegjësë ne shumen prej 4,251,972.89 euro për te cilën KOSTT-Operator, Sistemi, Transmisioni dhe Tregu sha, me NUI 811284512 e seli ne Prishtinë, e ka tërhequr pjesërisht propozimin e tij për përmbartim kundër debitori KESCO-Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike sha, me NUI811288887 me seli ne Prishtinë. Ne pjesën në II te dispozitivit te këtij aktvendimi ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO) sha, me NUI811288887 me seli ne Prishtinë dhe ka lënë ne fuqi urdhrin përmbartimor P.nr.384/2022 dt.18.08.2022 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj, me seli ne Prishtinë, sa i përket kamatëvonesës vjetore për kryegjënë dhe shpenzimet procedurale.

Kundër këtij aktvendimi, ne afat ligjor, ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkalles së dytë aktvendimin e atakuar ta anuloj ose ndryshoj aktvendimin e atakuar, ta ndryshoj dhe ta refuzoj propozimin e kreditorit për pjesën e dytë në lidhje me kamatëvonesën dhe shpenzimet e procedurës.

Dhoma e Shkalles së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

- Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori KOSTT- Operator, Sistemi, Transmisioni dhe Tregu sh.a, me numër unik identifikues 811284512, me seli në rr. "Isa Boletini" nr.39 në Prishtinë, me datën 06.05.2022, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO) sha, me NUI811288887 në Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturave nr.0674 dt.12.05.2022 në shumën prej 85,413.11 euro dhe faturën nr.0671 dt.12.05.2022 në shumën prej 4,166,559.77 euro. Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj me seli në Prishtinë, sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbartimor P.nr.384/22 dt.18.08.2022 ka lejuar përmbartimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit nga faturat, në afat prej 7 ditësh pune nga dita e pranimit të faturës, t'ia paguaj shumën prej 4,251,972.89 euro, me kamatë vjetore 4.5% vjetore sipas rregullave të tregut, nga data kur është dashur të paguaj faturat e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës.

Kundër urdhrin përmbartimor debitori ka paraqitur prapësim me datë 24.08.2022, përmes së cilit pretendon se dokumenti në bazë të cilit është iniciuar proceduara përmbartimore nuk është dokument i besueshëm dhe se kushti i përcaktuar në dokumentin përmbartues nuk është përmbushur përveç nëse parashikohet me ligj. Debitori në këtë rast i referohet edhe Raportëve konsultative sa i përket të hyrave nga KEDS, Komenteve mbi këto raporte, Raportëve të shqyrtimit të hyrave, planeve të veprimtimit mbi krizën energjetike dhe dokumenteve tjera të Qeverisë sa i përket masave emergjente. Propozon që gjykata ta aprovoj prapësimin e debitorit, urdhrin përmbartimor ta anuloj dhe ta obligoj kreditorin të paguaj shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Përgjigje në prapësimin e debitorit ka ushtruar kreditori me datën 31.08.2022, me arsyetimin se asnjë nga pretendimet e debitorit në prapësim nuk paraqet bazë nga neni 71 i LPP, KOSTT ka iniciuar propozim për përmbartim në bazë të dokumentit të besueshëm faturave të cilat janë në pajtim me nenin 29 par.1.3 të LPP. Pretendimet e debitorit nuk qëndrojnë dhe nuk janë objekt i trajtimit në procedurën përmbartimore dhe si të tilla nuk paraqesin shkak për prapësim, andaj

propozon që gjykata ta refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe urdhrin përmbarimor ta lë në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkalles së Parë, pas vlerësimit të prapësimin, përgjigjes në prapësim dhe pas mbajtjes së seancës dëgjimore, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.2154/22 dt.30.11.2023, me të cilin e ka përfunduar procedurën përmbarimore sa i përket kryegjësë ndërsa ka refuzuar prapësimin e debitorit sa i përket pjesës lidhur me kamatëvonesën vjetore për kryegjënë dhe shpenzimet procedurale, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka konstatuar se nga shkresat në lëndë nuk është kontestues se debitori ka përmbushur detyrimin nga borxhi kryesor prej 4,251,972.89 euro dhe se ky borxh është përmbushur pas kalimit të afatit 7 ditor nga data e pranimit të përcaktuar në faturat lëndore. Gjykata tërheqjen e kreditorit nga propozimi e ka marrë si tërheqje të pjesshme, rrjedhimisht gjykata ka gjetur se mund të vendos vetëm për kamatëvonesë dhe shpenzime procedurale të kërkuara dhe lejuara. Meqë kreditori ka tërhequr propozimin në fazën e shqyrtimit të prapësimin atëherë gjykata në bazë të dispozitave ligjore nuk e ka marrë pëlqimin e debitori për tërheqje dhe ka përfunduar procedurën përmbarimore. Kamatëvonesa është specifikuar 4.5% në faturat lëndore dhe se lartësia e kamatëvonesës është përcaktuar në faturat lëndore konform nenit 18 par.3 nenpar.4 të Rregullat e Tregut versioni 3.0 të nxjerra nga KOSTT të Tetorit 2018. Po ashtu në këtë rast vlejnjë edhe dispozitat e Ligjit 05/L-110 për Kamatëvonesat në Transaksionet Tregtare, neni 1,2 dhe 3 par.1.1 lidhur me nenin 11 të Ligjit, neni 4 par.1 e LKTT, 1.1, 1.2, par.6 nenpar.1 të njëjtë ligj. Sa i përket shpenzimeve procedurale gjykata ka vendos konform nenit 13 par.4 të LPP bazuar në faktin se kreditori ka kërkuar shpenzimet dhe kjo kërkesë është lejuar ndërsa debitori ka përmbushur vetëm kryegjënë por jo edhe shpenzimet procedurale, andaj nisur nga fakti i pa kontestuar mes palëve se debitori ka përmbushur obligimin e tij pasi ka filluar procedura përmbarimore atëherë rrjedh si i arsyeshem edhe kërkesa për shpenzime procedurale. Gjykata ka analizuar pretendimin e debitori se faturat lëndore nuk janë dorëzuar por e gjënë si të pabazuar sepse në fatura gjendet vula e pranimit të debitorit, po ashtu edhe pretendimin e debitorit se nuk është përgjegjës për pagesën e kamatës së kontraktuar për shkak të pandemisë COVID 19 por vlerëson se rrethanat pandemike nuk mund të merren si ngjarje që bie në përkufizimin e fuqisë madhore ndërsa pretendimin e debitorit përkitazi rritjes së çmimeve të energjisë elektrike e sheh të pabazuar sepse në rastin konkret vlerëson se debitori duhet të përgatitet ekonomikisht për rritjen ose uljen e çmimeve meqë lëvizjet e çmimit të tregun përkatës janë të natyrshme dhe të pritshme, prandaj lëvizjen e çmimeve gjykata nuk e sheh si rrethanë të fuqisë madhore. Debitori i ka pranuar faturat dhe nuk i ka kundërshtuar ato në aspekt të kryegjësë dhe kamatëvonesës në bazë të fuqisë madhoreose në ndonjë bazë tjetër siç ka pasur mundësinë konform nenit 7 par.1 të marrëveshjes për aderim në rregullat e tregut. Gjykata pati parashih edhe pretendimet tjera të debitorit por vlerësoj se nuk janë relevante për një vendosje ndryshe andaj ka vendos si në dispozitiv të aktvendimit.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore me

rastin e vendosjes, ngase me shikimin në shkresat e lëndës gjegjësisht deklaratimet e palëve ne seancën dëgjimore te dt.20.11.2023 dhe Parashtrësës se kreditorit nr.2154/22 dt.23.11.2023 drejtuar Gjykatës Komerciale, përmes se cilës sjell dëshmi nder tjera te pagesës se kryegjësë nga ana e debitorit duke i bashkangjitur kësaj parashtrëse edhe transaksionet bankare nga Raiffeisen Bank te pagesës se detyrimeve, me çka rezulton edhe për këtë gjykatë se debitori ka përmbushur ne tërësi borxhin kryesor ndaj kreditorit, ndërsa ka mbetur pa u paguar kamata ligjore nga data e arritshmërisë se pagesës sipas afatit ne fatura dhe shpenzimet procedurale, andaj përfundimin juridik te gjykatës e shkalles se parë ne lidhje me përfundimin e procedurës përmbarimore sa i përket detyrimit te kryegjësë e përkrah ne tërësi kjo gjykatë, shto kësaj edhe faktin se kreditori ne seancën dëgjimore ka deklaruar se tërheq pjesërisht propozimin përmbarimor vetëm sa i përket detyrimit për borxhin kryesor por jo edhe kamatëvonesës dhe shpenzimeve te procedurës përmbarimore, bazuar ne dispozitat ligjore dhe atë nenin 42 te LPP .

Edhe kjo gjykatë vlerëson faktin se meqë ne faturat si dokument mbi bazën e te cilave është lejuar përmbarimi kreditori ka precizuar kamatëvonesën prej 4.5% vjetore dhe fakti se debitori ka përmbushur borxhin nga kryegjësja, rezulton se tani më debitori ka ne obligim kamatëvonesën si dhe shpenzimet e procedurës ndaj kreditorit e kjo bazuar edhe ne faktin tjetër se debitori përmbushjen detyrimit kryesor e ka bërë pas inicimit te procedurës përmbarimore nga ana e kreditorit.

Ne lidhje me këtë çështje edhe kjo gjykatë vlerëson nenin 382 par.1 te LMD i cili parasheh qe *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”* ndërsa neni 384 par.1 i LMD parasheh qe *“Kreditori ka të drejtë në kamatëvonesën pa marrë parasysh nëse ka pësuar ndonjë dëm për shkak të vonesës së debitorit”*, ashtu qe konsideron qe përfundimi juridik i gjykatës e shkalles se parë është i drejtë dhe ligjor.

Në rastin konkret Gjykata e shkalles se dytë, pranon ne tërësi përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është i përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK e as ne konstatim te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Kjo gjykatë analizon edhe pretendimet ankimore te debitorit se vonesa ne përmbushjen e detyrimit është për shkak te forcës madhore dhe se debitori nuk duhet te mbahet përgjegjëses sa i përket kamatëvonesës dhe shpenzimeve te procedurës, por këto pretendime kjo gjykatë i vlerëson si te pabazuara dhe paargumentuara me prova konkrete prandaj te njëjtat i refuzoi ndërsa aktvendimin e atakuar e vërtetoj.

Kompetenca e Dhomës se Shkalles se Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,  
Dhomat e Shkallës së Dytë  
K.DH.SH.II nr.476/24, me datë 24.12.2024

Gjyqtari,  
Dren Rogova